



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:285103

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06296720

PPP.nr.449/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit Iute Credit Kosova Sh.A, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson kompania “Debt Collection Agency”, kundër debitorit F. (Sh.) Xh., me adresë në rr.”D. X.” nr.10, fshati B., M., lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej ...€, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.10.2024 nxjerr ketë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit F. (Sh.) Xh, i ushtruar kundër urdhërit përmbarues P.nr.... i datës ... mbi lejinin e përmbarimit të propozimit për përmbarim të datës 14.11.2023, në shumën prej ...€

II. LIHET në fuqi urdhërit përmbarimor mbi lejinin e përmbarimit P.nr.... i datës

Arsyetim

Kreditori, Iute Credit Kosova Sh.A me datën ... pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozimin për përmbarim sipas titullit përmbarimor – Marrëveshjes së linjës së kredisë nr....e datës ... dhe ankesi 1 – marrëveshja e pengut e datës ..., kundër debitorit F. (Sh.) Xh.

Përmbaruesi Privat, me urdhërin përmbarimor P.nr.... i datës ..., ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit Iute Credit Kosova Sh.A.

Kundër këtij urdhëri, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësimin duke i propozuar gjykatës që ta rafuzojë propozimin për përmbarim dhe ta anulojë urdhërin përmbarimor.

Në bazë të nenit 27 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore parashihet që “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

Gjykata, vlerëson se dokumenti përmbarimor - Marrëveshjes së linjës së kredisë nr.73809 e datës 27.04.2019 dhe ankesi 1 – marrëveshja e pengut e datës 27.04.2019, është i përshtatshëm për

përmbarrim dhe në të janë treguar kreditori, debitori, mjetet, përkatësisht shuma që ka detyrim debitori ku i njëjti ka marrë huanë në shumën prej ... me kamatë prej ... dhe koha e përmbushjes së këtij obligimi e cila ka qenë deri me datën

Gjykata, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësim nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, sipas të cilave do të pengohet urdhëri përmbarrimor.

Gjykata, konstatojë se debitori F. (Sh.) Xh, me datën ... kanë lidhur kontratën për huanë me numër ..., ku kreditori si huadhënës i ka dhënë debitorit shumën prej ...€. Me këtë rast, kreditori gjykatës i ka paraqitur këtë titull përmbarrimor dhe shkresat e tjera ku shihet se identifikimi i debitorit është bërë përmes leternjoftimit dhe numrit të tij personal dhe se këto marrëveshje debitori i ka nënshkruar dhe ka pranuar obligimet që rrjedhin nga to.

Gjykata vlerëson se debitori me asnjë fakt nuk i vërteton pretendimet e tij në prapësim se ai nuk e ka nënshkruar kontratën për kredinë dhe se pretenimet e tij janë tërësisht të pabazuar sepse kreditori ka paraqitur prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet fakti se debitori ka obligim ndaj kreditorit sikur në titullin përmbarrimor, përkatësisht Marrëveshjes së linjës së kredisë nr.... e datës

Gjykata, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se “*Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore*”, përjashtimisht Gjykata mund të caktoj seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin.

Andaj nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 73 të LPP-së, dhe në bazë të argumentimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.449/23, me datë 15.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.